


PORTOFOL MIKS

mundëson një balancë midis riskut dhe përfitimit

DIVERSIFIKIM I INVESTIMEVE

për fondet në monedhë të huaj

TREGJE NDËRKOMBËTARE

Pjesëmarrje në tregjet e huaja të aksioneve/ obligacioneve

Raport Mujor Mars 2025

Informacion bazë

Emri i Fondit	Raiffeisen MIKS
Administrimi i Fondit	Raiffeisen Invest sh.a
Monedha	Euro
Datë Lancimi	16 Nëntor 2020
Vlera fillestare e kuotës	100
Shuma minimale e investimit	500 Euro
Vlera neto e Aseteve	EUR 3,803,273
Cmimi i kuotës	104.9990
Banka depozitare	Banka e Pare e Investimit, Albania
Banka nëndepozitare	Raiffeisen Bank International, Austria
Numri i Investitorëve	110
Kthimi vjetor nga investimi në 31 Mars 2025	+3.52%

Komisione dhe Tarifa

Tarifë në hyrje	0.00%
Tarifë në dalje	0.00%
Tarifë administrimi vjetore	Deri në 1.30%
Tarifa te tjera te vazhdueshme	Kalkulohen ne fund te vitit kalendarik dhe perfshijne tarifën e paguar ndaj bankes depozitare, auditorit të jashtëm, autoritetit rregullator apo kostot për komunikimin e ndryshimeve në prospekt.
Komisione/tarifa të vazhdueshme	1.57% per vitin 2024 ne 31.12.2024
Komisione të transfertës nga shlyerja e kuotave	Referojuni informacionit ne deget e RBAL
Kosto të transaksioneve	Sipas kushteve të punës të palëve ndërmjetësuese

Objektivi dhe Politika e investimit

Objektivi i investimit të Fondit është krijimi i të ardhurave të rregullta dhe një rritje e moderuar e kapitalit në një periudhë afatmesme. Asetet e fondit investohen në instrumente financiare që i përkasin tre kategorive kryesore të asetëve: Tituj borxhi, Aksione, Tregu i parasë dhe ekuivalentë cash-i. Në mënyrë që të arrihet qëllimi i investimit, fondi investon deri në 75% të totalit të asetëve në Tituj borxhi, të cilat emetohen nga Qeveria e Republikës së Shqipërisë, një vend i BE-së apo çdo shtet tjetër i miratuar nga rregullatori vendas, nga institucionet ndërkombëtare

dhe / ose shoqëri tregtare. Për më tepër, për të maksimizuar kthimin total nga investimi, fondi mund të investojë deri në 40% të asetëve në aksione, kryesisht të tregtuar në tregjet e zhvilluara në SH.B.A. dhe Europë. Nëse do të përdoren instrumente financiare derivative, qëllimi do të jetëz butja e risqeve dhe arritja e objektivave të politikës së investimit, por faktorë të tillë si likuiditeti i instrumentit tek i cili mbështetet derivativi dhe luhatshmëria e vlerës së tij mund të ndikojnë në performancën e fondit.


Profili i Riskut dhe Përfitimit

Risk i ulët

Përfitimet tipike më të ulëta

Risk i lartë

Përfitimet tipike më të larta




Profili i parashikuar i riskut të Fondit Raiffeisen Miks i përket kategorisë së katërt të treguesit të riskut sintetik dhe përfitimit.

Treguesi i riskut dhe përfitimit korrespondon me një numër të plotë i cili përdoret për të renditur fondin në një nivel risku nga 1 në 7, sipas nivelit të rritjes të luhatshmërisë. Kategoria më e ulët nuk do të thotë që investimi në fond është pa risk.

Ky tregues ka për qëllim t'ju informojë mbi luhatshmërinë e çmimit të kuotës së fondit bazuar në historikun e performancës së fondit. Të dhënat historike të përdorura për llogaritjen e treguesit nuk mund të përbëjnë një siguri të plotë për profilin e riskut në të ardhmen.

Struktura e Portofolit të Investimit



Portofoli i fondit Miks është i ndërtuar në një mënyrë të tillë që të përfitojë nga investimi dhe diversifikimi në të dy kategoritë e asetëve siç janë obligacionet dhe aksionet.

Obligacionet janë të investuara 30.1% në tituj borxhi dhe fonde investimi me kthim të lartë (high-yield), ku 27.3% i përket titujve të Qeverisë Shqiptare, si dhe 32% në obligacione dhe fonde investimi me vlerësim të lartë (investment-grade).

Pjesa e aksioneve (35.3%) është e investuar në tregje të zhvilluara: SHBA 21.1%; Zona Euro 10.8%, Britani e Madhe 1.8% e asetëve totale. Niveli i cash dhe i likuiditetit është ulur në 2.7% në fund të muajit mars.

Performanca e fondit

Fondi ka shënuar një ecuri negative mujore prej **-2.44%** gjatë muajit mars.


Tregjet globale të borxhit pësuan rënie në mars dhe yield-et e obligacioneve ishin në rritje. Në nivel indeksi, obligacionet e korporatave në monedhën Euro vazhduan të tejkalojnë homologët e tyre në monedhën Dollarë. Tregjet e aksioneve ranë ndjeshëm në fillim të muajit, përpara se të rikuperonin disa nga humbjet deri në fund të muajit. Shkaku kryesor i kësaj rënieje

masive ishin shqetësimet rreth rritjes ekonomike të SHBA-së, të nxitura nga pasiguria mbi tarifën. Zhvillimet e tregjeve financiare në mars patën një ndikim negativ në portofolin e investimeve të fondit Raiffeisen Miks, i cili shënoi humbje gjatë muajit. Yield-i mesatar i portofolit të investimeve të fondit është 3.48% për një kohëzgjatje mesatare prej 3.03 vjet më 31 mars. **Kthimi neto vjetor i fondit është +3.52% më 31 mars 2025.**



Ne dt 31 mars 2025	1 Vit	2 Vite	3 Vite	Nga lancimi (16 Dhjetor 2020)
Return in % p.a. for the period	+3.52%	+6.35%	2.60%	+1.14%

Kthimi Neto i fondit Raiffeisen Miks per çdo vit



Duhet patur parasysh se norma e kthimit ndryshon në varësi të kushteve të tregut dhe çmimi i kuotës mund të jetë i luhatshëm, pra nuk është statik apo gjithmonë në rritje, por edhe mund të bjerë si pasojë e ndryshimeve të kushteve në treg. Lulahshmëria është pjesë e natyrshe e fondeve të investimit dhe eliminimi total i saj është i pamundur.

Investitorët e fondit Raiffeisen Miks dhe të gjithë fondeve të administruara nga Raiffeisen Invest këshillohen të kenë një horizont sa më të gjatë investimi për të përfituar një kthim optimal nga investimi dhe në këtë mënyrë në periudha afatmesme apo afatgjate të kenë mundësi të rikuperojnë edhe efektet negative të krijuara afatshkurter.

Investitorët inkurajohen që të ruajnë investimin e tyre duke mos ndryshuar objektivin e qëndrimit në fond të nxitur nga situatat jo të zakonshme të krijuara perkohësisht në tregjet financiare, sepse në këtë mënyrë nuk do të riskojnë të dalin nga fondi në momentin e gabuar për investimin e tyre.

Zhvillimet dhe informacion mbi ecurinë e tregjeve financiare gjate muajit Mars

Inflacioni vjetor i Eurozonës u ul sipas pritshmërive në nivelin 2.2% në mars. Kjo vlerë qëndron pak më poshtë nivelit përfundimtar prej 2.3% të shkurtit. Inflacioni bazë, i cili përjashton çmimet e paqëndrueshme të ushqimeve, energjisë, alkoolit dhe duhanit, u ul në 2.4% në mars nga 2.6% në shkurt. Bashkimi Europian është në pritje të tarifave të vendosura nga Presidenti i SHBA-së, Donald Trump, duke përfshirë një taksë prej 25% për makinat e importuara.

Në SHBA, indeksi i çmimeve të konsumit për të gjithë artikujt dhe ai bazë u rrit me 0.2% në shkurt, pak më poshtë pritshmërive. Në bazë vjetore, inflacioni total ishte në nivelin 2.8%, ndërsa ai bazë në 3.1%. Të dyja ishin gjithashtu 0.1 pikë për qindje nën konsensusin e tregut dhe nivelet e muajit të kaluar. Raporti shkaktoi një lehtësim në tregje, pasi konsumatorët dhe bizneset shqetësohen për ndikimin e rrezikshëm që mund të kenë tarifatat në inflacion.

Banka Qendrore Evropiane uli normat e interesit për të gjashtën herë që nga qershori dhe tregoi se faza e uljes së normave mund të jetë drejt fundit, ndërsa inflacioni zbutet dhe ekonomia përballet me ndryshime sizmike në gjeopolitikë. Norma e depozitave u ul me 0.25 pikë në 2.5%. Zyrtarët e përshkruan politikën e tyre monetare si “dukshëm më pak shtrenguese” dhe përsëritën se nuk do të angazhohen për të ndërmarrë një drejtim specifik për sa i përket kostove të huamarrjes.

Rezerva Federale mbajti normën bazë në të njëjtin nivel, midis 4.25% dhe 4.5% dhe la të pandryshuara linjat kryesore të deklaratës mbi politikën e saj. Ndryshimi kryesor në deklaratë ishte njoftimi se, duke filluar nga prilli, Komiteti Federal do të ngadalësojë ritmin e shtrengimit sasior.

Tregjet globale të borxhit qeveritar pësuan rënie në mars dhe yield-et e obligacioneve ishin në rritje. Yield-et e obligacioneve 10-vjeçare gjermane shënuan lëvizjen më të madhe, duke u rritur me 34 pikë gjatë muajit, për të përfunduar në nivelin 2.73%. Një nga faktorët kryesorë ishte njoftimi i qeverisë së re gjermane se do të “lirojë frenat e borxhit”, një masë që do të lejojë shpenzime më të larta për mbrojtjen. Në nivel indeksi, obligacionet e korporatave në monedhën Euro vazhduan të tejkalojnë homologët e tyre në monedhën Dollarë., duke shënuar herën e parë që nga janari 2022 që spread-et e obligacioneve në Euro janë më të ulëta se ato në Dollarë.

Tregjet e aksioneve ranë ndjeshëm në fillim të muajit, përpara se të rikuperonin disa nga humbjet deri në fund të muajit. Shkaku kryesor i kësaj rënieje masive ishin shqetësimet rreth rritjes ekonomike të SHBA-së, të nxitura nga pasiguria mbi tarifatat dhe ndikimi i normave më të larta të obligacioneve dhe kredive. Indeksi S&P 500 i SHBA-së ra -6.16% dhe indeksi i teknologjisë NASDAQ humbi -8.14% për muajin. Tregjet europiane performuan pak më mirë, duke përfituar nga rotacioni i vazhdueshëm i investitorëve që kërkojnë alternativa ndaj SHBA-së. Indeksi STOXX Europe 600 ra -3.72%.

Me dobësimin e treguesve teknikë, përqësimin e ndjesisë në tregje dhe rezultatet gjithnjë e më të vështira për t'u parashikuar të politikave monetare, perspektiva mbetet e paqartë. Në vazhdim, tregjet po përgatiten për ngjarjen tjetër të rëndësishme politike: vendosjen zyrtare të tarifave shtesë të planifikuara për datën 2 prill - të quajtur si "Dita e Çlirimit" nga Presidenti Trump.

Në një tjetër linjë, S&P Global Ratings ka përmirësuar vlerësimin kreditor afatgjatë të Shqipërisë nga 'BB-' në 'BB', me një perspektivë të qëndrueshme. Ky përmirësim pasqyron perspektivat e fuqishme ekonomike të Shqipërisë, të mbështetura nga investime direkte të huaja të konsiderueshme, flukse hyrëse të remitançave dhe një sektor në lulëzim të eksportit të shërbimeve.

Të dhënat e kthimit nga investimi në të shkuarën janë vetëm ilustrative dhe nuk përfaqësojnë një premtim apo garanci për kthimin në të ardhmen. Të gjithë shembujt e tjerë numerikë janë përdorur për qëllime ilustrative dhe analize të të dhënave historike, dhe nuk duhen përdorur nga investitorët për të nxjerrë konkluzione për të ardhmen.

Investitorët e mundshëm duhet të lexojnë Prospektin dhe Rregullat e Fondit. Raiffeisen Invest dhe forca shitëse e fondit nuk garantojnë një kthim të caktuar të fondit.

Informacioni mbi çmimin e përditësuar të kuotës, prospektin dhe rregullat e Fondit gjendet pranë zyrave të Raiffeisen Invest sh.a., në web site www.raiffeisen-invest.al ose në degët e Raiffeisen Bank në Shqipëri.